



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË

KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Zhvillimin urban, ndertimin dhe mbrojtjen e mjedisit

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 16.10.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 3 datë 07/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për "emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë" Një shtesë në vendimin nr. 47 datë 17.12.2004, "Për emertimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë"

Analiza ligjore: Në mbështetje të: Nenit 8 pika 2, neni 9 nënpika 1.7, shkronja "b", neni 54 shkronja "II", nenit 55 pika 2 e 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar), Nenit 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25 e 26, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "për sistemin e adresave" (i ndryshuar), Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar), VKB-në nr.47 datë 17.12.2004 "Për emertimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të bashkisë Pukë" Si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë.

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Administrata e bashkisë propozon që këshilli i Bashkisë Pukë të miratojë emërtimin e rrugës nga këndi i njoftimeve në qendër deri te Xhamia e qytetit Pukë, me emrin "Rruga e Xhamisë", sipas planvendosjes bashkëlidhur

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm për Zhvillimin urban, ndertimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimit.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton jetën e të gjitha shtresave, kategorive në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi me publikun

Komisioni i Përhershëm për Zhvillimin urban, ndertimin dhe mbrojtjen e mjedisit , i mbledhur me datën 16/10/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 3 datë 07/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për "emërtim rruge në territorin e Bashkisë Pukë" Një shtesë në vendimin nr. 47 datë 17.12.2004, "Për emertimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të Bashkisë Pukë", paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Alban Nosh

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Adnan Hoxha

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

Datë 16.10. 2025

[Signature]